NATA E KADRIT
DHE SHEKULLI I ISLAMIT!

MUAJI I RAMAZANIT

HISTORIA E GJYKATËSIT
IBN HUBEJRA

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 23 - Nr. 3 (265), Mars, 2025

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990

Nata e Kadrit,

rrugëtim drejt "Pozitës së Naltë!"

Xhamia e Pejgamberit (a.s) | Medineja e Ndriçuar

MUKABELEJA E RAMAZANIT
NË XHAMINË E PARRUCËS
NJË TRADITË E PËRVITSHME

"KËSHILLA DITORE E RAMAZANIT"
CIKËL LIGJËRATASH
NË XHAMINË "EBU BEKËR"

MYFTIU I SHKODRËS
MBAN HYTBEN E FUNDIT
TË RAMAZANIT 1446/2025

MYFTINIA SHKODËR VAZHDON
SHPËRNDARJEN E NDIHMAVE
TË RAMAZANIT

NATA E KADRIT, XHAMITË E SHKODRËS
GJALLËROJNË ME PRANINË E RINISË

FALJA E FITËR BAJRAMIT
DHE NEVOJA PËR ZGJERIMIN
E XHAMIVE TË MËDHA

NATA E KADRIT DHE SHEKULLI I ISLAMIT!

Kjo fé e pastër dhe e naltë, me të cilën, Zoti Fuqiplotë, Një dhe i Vetëm, don të na zbukurojë jetën; do të përhapet e do të mbërrijë ku ka mbërritur nata dhe dita..!

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

I shim studentë në Damask, kur Hoxha i jonë i madh, Kryemyftiu sirian, Shejkh Ahmed Keftaro, rahmet pastë, që kishte vizituar kryeqendrat e botës, dëshmonte, se: (Pa asnjë dyshim se shekulli 21, është shekulli i Islamit!)

Dhe kishte plotësisht të drejtë! Sot, përherë e më shumë po shohim se si njerëzimi po kthehet me vëmendjen e tij nga Islami, si alternativë e shpëtimit nga katrahurat dhe humnerat, ku sistemet njerëzore të dështuara e kanë sjellë botën, duke e bërë njeriun armik të njeriut, duke përhapur përherë e më shumë sëmundje, epidemi, viruse, e luftëra gjakatare, gjakderdhje e tymnajë, shkatërrim e ambicie të djallëzuara kundër jetës dhe vetë racës njerëzore!

Kudo nëpër Evropë e perëndim, numri i vazhdueshëm në rritje i konvertimeve në Islam, është sinjal i fortë se dielli nuk mund të mbulohet me përpjekje të djallëzuara, porse rrezet e tij do të depërtojnë, duke dëbuar errësirat, me a pa dashjen e tyre.

Kështu, edhe kjo fé e pastër dhe e naltë, me të cilën, Zoti Fuqiplotë, Një dhe i Vetëm, don të na zbukurojë jetën; do të përhapet e do të mbërrijë ku ka mbërritur nata dhe dita, jo thjeshtë për statistikë e numër, por si realitet i dështmuar dhe mundësi rimëkëmbjeje për mbarë njerëzimin!

Nata e Kadrit, si perceptim i veçantë, na jep mundësinë të zgjohemi e të punojmë pambarimisht për këtë Rimëkëmbje drejt "Pozitës së Naltë", që është simbolika e kësaj Nate të mrekullueshme adhurimesh të panumërta, që racës njerëzore i falin Selam-Paqe, "deri në agim" të një dite të re për mbarë njerëzimin dhe jetën mbi faqen e dheut!

(Në atmosferën e Natës së Kadrit, më 26 mars 2025)



"RAMAZANI VJEN EDHE PËR TY! LARG VETËVRASJES!"

Muaji i Ramazanit sjell përherë qetësi e gëzim, angazhim për të bërë mirë e vrapim drejt dyerve të solidaritetit me njeriun në nevojë.

Vjen, si fllad i padukshëm, që na freskon, pas një thatësire të gjatë, që na ka përvëluar e transformuar.

Ditën e parë të Ramazanit, më 1 mars 2025, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i është drejtuar besimtarëve me një video mesazh, duke i uruar muajin e Begatë të Ramazanit, por edhe duke theksuar rëndësinë, vlerën dhe mirësinë që ka ky Muaj për mbarë muslimanët dhe mesazhet e mëdha, që mbart.

Ndër të tjera, Myftiu thekson, se: "Muaji i Ramazanit sjell përherë qetësi e gëzim, angazhim për të bërë mirë e vrapim drejt dyerve të solidaritetit me njeriun në nevojë.

Vjen, si fllad i padukshëm, që na freskon, pas një thatësire të gjatë, që na ka përvëluar e transformuar.

Është muaji i njeriut! Po, po, një Muaj enkas për njeriun që kërkon vetveten, që është në pritje të një shkëndije shprese, të një rreze drite të munguar... Edhe e njeriut që ka humbur shpresën, që mendon vetëvrasjen, që shumëzon çdo gjë me zero dhe i jep fund jetës së tij duke shkatërruar veten e familjen e duke mos lejuar që drita e udhëzimit të mbërrijë në qenien e tij!

Ky Muaj vjen, që njeriu të veçohet me Zotin e tij dhe të bëjë ndryshe llogaritë ditore, duke rregulluar çfarë është prishur e, duke ia hapur zemrën Zotit të gjithësisë, para duarve të Cilit, të gjithë jemi krijesa nevojtare të mëshirës së Tij, që na zgjon e na jep jetë!"

Në këtë mesazh, ka një këshillë për shumë kategori njerëzish, që agjërimi do t'ju zbukuronte jetën dhe do ju ndërronte pamje!

PO TI, I KUJT JE?

Sonte është mesi i Muajit Ramazan 1446. Është momenti për ta parë veten në pasqyrën e argumenteve të shumta, me të cilat, Allahu i Madhëruar na fton nëpërmjet kësaj periudhe të begatë njëmujore, për të hyrë në itikaf të mrekullueshëm shpirtëror, për të kuptuar thellësinë e thirrjes: "Agjërimi është i Imi dhe Unë e jap shpërblimin për të!"

A je gati ta pyesësh veten: Po ti, i kujt je? I Allahut? I Pejgamberit? I Kur'anit? Apo, i epsheve? I hutimit? I shejtanit?..

Është periudha më e begatë, pas së cilës presim Natën e Kadrit, si një kulm i jashtëzakonshëm që shënon edhe mundësinë e përjetimeve të mëdha, në këtë rritje të përditshme dhe të përnatshme drejt Naltësisë, simbolikë e së cilës është pa asnjë dyshim edhe Nata e shumëpritur e bekimeve të mëdha, sa një jetë adhurime!

Po ti, i kujt je?

Imam Muhamed B. Sytari
Sulgen, Zvicër 14/3/2025

H. VEHBI S. GAVOÇI
(1923 - 2013)

"

Namazi i Teravisë

Jena mësu qyshë të veqjël me e falë Teravinë në xhaminë e Garucit në Shkodër me 20 reqatë.

U rritme e shkuam në Siri, (Damask) e edhe atje Teravinë e falshim me 20 reqatë.

Shkova në Egjipt me mësue për fenë islame ku qëndrova 10 vjet edhe atje e falshim Teravinë me 20 reqatë.

Po në atë mënyrë e falshim Teravinë edhe në Mekkë e në Medine ku qëndrova për 8 vjet, edhe sot përsëri e falin Teravinë me 20 reqatë me të mirën e Zotit (xh.sh).

MUAJI I RAMAZANIT

H. Vehbi S. Gavoçi
(1923 - 2013)

Ky është muaji i nëntë në kalendarin islam (muaji hanorë. Në këtë mua të madhnueshëm Zoti (xh.sh) caktoi disa ngjarje dhe disa kujtime që nuk harrohen kurrë:

1. Në të zgjodhi Zoti (xh.sh) Muhammedin (a.s) si profet dhe i dërguar për mbarë njerëzinë, që në kohën e tij e deri në mbarim të kësaj bote.

2. Në këtë muaj ka filluar zbritja e Kur'anit të Madhnueshëm Muhammedit (a.s). Thotë Zoti (xh.sh) në Kur'an: "Në muajin e Ramazanit u zbrit Kur'ani si udhërrëfyes për njerëzit!"

3. Në muajin e Ramazanit iu shtohen shpërblimet e punëve të mira atyre që njinojnë, dhe ju naltësohen gradat te Zoti (xh.sh). Na tregon Selman Farisija: "Na foli Profeti (a.s) në ditën e fundit të muajit Shaban ku na tha: "Po ju afrohet një muaj i madh, një muaj që në të është një natë, e cila ka vleftën e më shumë se njëmijë muajve të tjerë. Ju ka vu si detyrë Zoti (xh.sh) njinimin e muajit të Ramazanit, me e falë teravinë (synet), ai që ban në këtë muaj një punë të mirë është si me plotësue një detyrim jashta këtij muaji, ai që plotëson detyrimet (falë farzet) quhet si me ba 70 detyrime në një muaj tjetër. Ramazani është muaji i durimit dhe durimi ashtë për xhenet. Ramazani është muaji i mëshirës, është muaji që shtohet në te rizku i myslimanit, ai që i jep me prishë dikujt në orarin e prishjes (yftar) shkakton faljen e mëkateve dhe lirimin nga zjarri e ka sevapë (shpërblim) si ai që e ka mbajt muajin e Ramazanit, pa iu pakësue gja nga sevapi i të dytit!".

Thanë: O i Dërguari i Zotit (xh.sh), ne të gjithë nuk kena mundësi me ushqye të tjerët.

Në atë rast Profeti (a.s) tha: "Mëshiruesi i madh, Zoti (xh.sh) ia jep atë shpërblim të madh atij që i jep tjetrit për me prishë, një kokërr hurme, pak ujë ose pak qumësht. Ky është një muaj që fillimi i tij është mëshirë, mesi i tij falje mëkatesh dhe fundi i tij është shpëtim nga zjarri!"

"Në këtë muaj të madhnueshëm shumoni katër gjana, dy prej tyre iu sjellin pëlqimin e Zotit (xh.sh) dhe dy të tjera me të cilat fitoni pëlqimin e Zotit (xh.sh). Dëshmija se Zoti (xh.sh) ashtë një dhe se Muhammedi (a.s) asht i Dërgumi i Tij dhe robi i Tij; dhe kërkoni me ju falë të metat dhe mëkatet. Ato dy gjana që janë shumë të domosdoshme për ne dhe me ato fitojmë pëlqimin e Zotit (xh.sh) janë: Të kërkojmë prej Zotit (xh.sh) me na futë në xhenet dhe me na ruajt nga zjarri!"

Ai që i jep atij që njinon ujë ose ushqim për me prishë në kohën e yftarit, atë Zoti e kënaqë me pi ujë nga Haudi i Profetit (a.s), ai që pin nga ai ujë nuk do të ketë kurrë ma etje!". Haudi është prroni i Profetit (a.s) për besimtarët në ahiret. (Transmeton Ibn Khuzejme)

4. Hapen dyert e Xhenetit në pritje të atyre që i përmbledh e i mbërrin mëshira e Zotit (xh.sh) e pëlqimi i Tij dhe mbyllen dyert e zjarrit për ato që kanë mbajt këtë muaj të shenjtë e të madhnueshëm.

5. Thotë Profeti (a.s): "I jepen myslimanëve në muajin e Ramazanit pesë sende (gjana) që nuk iu janë dhanë kujt tjetër përveç myslimanëve.

E para asht se në natën e parë të tij Zoti (xh.sh) i kqyrë ata që kanë njinue, e ke kqyrë Zoti (xh.sh) një herë ai nuk digjet në zjarr.

E dyta asht se era e gojës së tyne nga fundi i ditës ashtë ma e mirë te Zoti (xh. sh) se era e myshkut.

E treta asht se engjujt i luten Zotit (xh.sh) natë e ditë për ta (për besimtarët).

E katërta asht se Zoti (xh.sh) urdhëron xhenetin me u zbukuru në pritje të robëve të tij që janë lodhë në këtë botë dhe do të pushojnë në Parajsë.

E pesta asht se në natën e fundit të Ramazanit Zoti (xh.sh) iu falë të gjithë atyre që kanë njinu mëkatet!" Pyeti një sahabe e tha: Ajo natë a asht nata e Kadrit?

Profeti (a.s.s) tha: "Jo, a nuk e shef se punëtorët kur punojnë iu jepet rroga kur e kryejnë krejtë punën e kërkueme"!? (Transmeton Imam Ahmed)

Marrë nga libri:
Shtyllat e islamit - **Njinimi**

MYFTIU I SHKODRËS MBAN HYTBEN E FUNDIT TË RAMAZANIT 1446/2025

Ky muaj na nxiti drejt solidarizimit me njëri-tjetrin, e shumëfishoi vlerën e sadakasë në këtë muaj të Madhërishëm të Ramazanit, sa që i shikoje njerëzit duke vrapuar dhe duke bërë gara, se kush të ndihmojë, të japë dhe të bëjë më mirë për nevojën e tjetrit... qindra e qindra familje në nevojë janë ndihmuar gjatë këtij muajit të Madhërueshëm të Ramazanit.

Nga hytbeja e xhumasë në xhaminë e Parrucës, më 28 mars 2025, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, iu drejtua besimtarëve të pranishëm duke folur për mirësitë dhe begatitë e muajit të Ramazanit, me shprehjen se: "Shkon një muaj!"

Myftiu vuri theksin te qëllimi i agjërimit të muajit të Ramazanit, të cilin Allahu i Madhëruar e obligoi në "ditë të numëruara!". Megjithëse Allahu i ka justifikuar ata, të cilët janë të sëmurë dhe nuk mund ta agjërojnë, por ndërkohë thotë për pjesën tjetër: "Nëse agjëroni është më e mirë për ju!"

Ai, gjithashtu tërhoqi vëmendjen, që në asnjë mënyrë, besimtari nuk duhet ta braktisë atë që ka arritur gjatë Ramazanit, prej adhurimeve, veprave të mira, bamirësisë, etj, por të vazhdojë dhe të ecë në gjurmën e tyre, sepse braktisja e tyre është një zullum i madh në hak të Ramazanit dhe në hak të gjithë adhurimeve të tjera.

Ai theksoi, se: "Nëse ti e di, se i ke ditët e numëruara në këtë jetë, si do të silleshe dhe si do të veproje? Do të veprosh me shpirtin e kësaj pjese të bekuar të ajetit: Nëse agjëroni është më e mirë për ju!, pra të qëndroni në besën e agjërimit dhe të qëndroni në besën e Allahut të Madhëruar, është më e mirë për ju! Sepse thotë, në hadithin që na e mëson Pejgamberi (a.s): Agjërimi është i Imi dhe unë e shpërblej atë!..."

Gjatë hytbes së tij, Myftiu gjithashtu theksoi, se: "Na u vërtetua nëpërmjet këtij muaji të Madhërishëm të Ramazanit se, në Islam, krejt problemet e njeriut, thuaj të njerëzimit, mund të zgjidhen në një muaj të vetëm. Na u vërtetua botërisht, dhe këtë e gjë e pamë edhe nëpërmjet mjeteve të informacionit, se njerëzit anembanë botës u paqtuan në këtë Ramazan, njerëzit u solidarizuan me njëri-tjetrin në këtë Ramazan, njerëzit lanë pas krahëve mëritë dhe urrejtjen në këtë Ramazan, njerëzit për hatër të këtij muaji të Ramazanit hapën zemrat e tyre për njëri -tjetrin, duke praktikuar të mirën, duke përhapur të mirën, duke u distancuar nga e keqja dhe gjërat e tjera të ndaluara.

Pejgamberi (a.s) na dëshmoi, se sistemi i korrupsionit, i hiles, i mashtrimit, i pabesisë, nuk ka të bëjë me agjëruesin dhe me vlerat, normat dhe standardet islame.

Mësuam gjatë muajit të Ramazanit për ta dëbuar të keqen nga mesi jonë, për të mos e pranuar të keqen në mesin tonë. Mësuam nëpërmjet kësaj shkolle një-mujore vetëpërmbajtjen në jetën e përditshëm, duke thënë: "Unë jam agjëruesh ëm, unë jam agjëruesh ëm!"

Ky muaj na nxiti drejt solidarizimit me njëri-tjetrin, e shumëfishoi vlerën e sadakasë në këtë muaj të Madhërishëm të Ramazanit, sa që i shikoje njerëzit duke vrapuar dhe duke bërë gara, se kush të ndihmojë, të japë dhe të bëjë më mirë për nevojën e tjetrit... qindra e qindra familje në nevojë janë ndihmuar gjatë këtij muajit të Madhërueshëm të Ramazanit."

Gjatë këtij ligjërimi, Myftiu theksoi, se: "Ne kemi sistemin e vlerave që mbizotëron mbi çdo sistem tjetër në botë, sepse ka burimin hyjnor. Të kapemi pas Kur'anit tonë, të rrimë krenarë me Kur'anin dhe të mos devijojmë prej këtij Kur'ani, që është Libri, i cili ka zbritur në këtë muaj të Madhërishëm të Ramazanit!"

Myftiu Sytari u ndal edhe te çështja e Gazës, ku theksoi se ajo është kryefjala e këtij Ramazani dhe kryefjala e gjithë botës prej dekadash, e në veçanti në këtë vit të fundit, që bashkërisht dëshmojmë një ndër llahtaritë dhe krimet barbare më të frikshme të historisë së njerëzimit kundër njerëzve të pafajshëm.

Në fund, Myftiu u lut, që Allahu i Madhëruar ta begatojë Shkodrën dhe ta ruajë atë nga çdo ligësi, nga çdo përpjekje për ta ç'bërë, nga çdo përpjekjen për ta zhveshëur nga shpirti i traditës dhe nga shpirti shekullor i besimit, harmonisë, dashamirësisë, vëllazërisë, që qytetarët e këtij vendi kanë me njëri-tjetrin.

HISTORIA E GJYKATËSIT IBN HUBEJRA

(Një nga historitë më të mëdha të historisë islame)

"Kush e ka frikë Allahun, Ai do t'i bëjë rrugëdalje dhe do ta furnizojë nga nuk e pret. Kush i mbështetet Allahut, Ai i mjafton!" – (Kur'ani, Et-Talak: 2-3)

Një person nga shkretëtira erdhi në Bagdad për të kërkuar dituri dhe për të bërë tregti. Ai mori me qira një dhomë për të jetuar. Pas faljes së sabahut dilte për të punuar dhe pas drekës shkonte në mësime të dijes dhe të njohurive.

Ky djalosh e ndante pagën e tij në tre pjesë:

1/3 për babanë e tij

1/3 për pronarin e dhomës

1/3 për shpenzimet e tij, për të jetuar

Kaluan tre muaj dhe ai nuk po arrinte të paguante qiranë, dhe pronari i dhomës i tha: "Ke tre ditë kohë për të paguar qiranë, përndryshe do të të fus në burg. Unë nuk e kam ndërtuar këtë shtëpi vakëf për fukarenjtë!"

Doli ditën e parë për të kërkuar punë, por nuk gjeti.

Shkoi te zyra e haraçit për të kërkuar punë, por nuk gjeti as aty. Derisa erdhi dita e tretë, dita e burgosjes së tij.

Doli nga shtëpia i dëshpëruar e duke mbartur mbi supe tërë dynjanë.

Thotë: Fillova të ecë, derisa mbërrita në rrethina të Bagdadit. Aty gjeta një shtëpi gati të rrënuar. Thashë: Po pushoj dhe vendosa dorën te dera, e ajo kishte qenë e hapur.

Ndërkohë, një plak i moshuar ishte i shtrirë në shtrat. Më thirri duke më thënë: Dëgjo o biri im: Pasha Allahun, nuk të ka sjell tek unë, veçse Allahu. Unë jam në çastet e vdekjes, por më ka shkuar mendja të ha pak rrush.

I thashë: Përgëzoju, pasha Allahu patjetër do të hash sot rrush...

Dola në treg dhe shkova te shitësi i frutave dhe e pyeta: Me sa është rrushi? Tha: Një dirhem.

I thashë: Merr këto plaçkat e mia si peng (kapar) te ti deri sa të të sjell paratë. E mora rrushin dhe ndërkohë unë vrapoja në mënyrë që të arrija tek ai përpara se të vdiste. Ia dhashë rrushin, edhe pse unë kisha më shumë nevojë se sa ai!

Pasi e hëngri rrushin më tha: Dëgjo o biri im. Në atë qoshe të dhomës, gërmo dhe poshtë sa do të gjesh diçka.

Fillova të gërmoj derisa gjeta një qyp të mbushur me para e flori. Ia dhashë dhe ai ma shprazi të gjithin në rrobat e mia, pastaj më tha: Këto janë për ty. Por, për këtë pasuri ka një histori, o biri im.

Unë dhe vëllai im kemi qenë dy tregtarë të mëdhenj, që shkonin në Indi dhe Sind. Tregtonin mëndafsh dhe lesh. Kishim frikë prej hajdutëve dhe plaçkitësve. Një ditë prej ditësh hymë në një shtëpi dhe i thashë vëllait: Këtë shtëpi e vizitojnë shumë plaçkitës dhe unë kam frikë për paratë e mia dhe të tuat. M'i jep paratë e tua dhe t'i fsheh me paratë e mia në një vend të sigurt, pastaj t'i kthej ty. Nëse zgjohemi shëndosh e mirë i marrim paratë tona dhe vazhdojmë rrugën.

Thotë: Pa rënë mirë për të fjetur së bashku me vëllain, kur ia behën hajdutët, vranë kë vranë dhe plaçkitën kë plaçkitën. Nuk u zgjova, veçse nga i nxehti i diellit i ditës tjetër. Fillova të kërkoj për vëllain, por nuk e gjeta, as në mesin e të gjallëve dhe as në mesin e të vdekurve. Hyra në Bagdad dhe ndërtova këtë shtëpi, dhe i fsheha paratë, që janë paratë e vëllait tim, që njëzet vjet më parë.

Nëse vdes, ato janë hallall për ty. Pastaj, shqiptoi shehadetin dhe vdiq!

Thotë: I fsheha paratë dhe dola të kërkoj ndihmë për ta varrosur këtë plak. Pasi e varrosëm, u ktheva dhe mora qypin me flori. Pasi kisha qenë i varfër e i këputur, u bëra prej pasanikëve të Bagdadit.

Thotë: I mora paratë dhe shkova te shitësi i frutave dhe ia dhashë parat e rrushit, e ai më ktheu plaçkat e mia. Pastaj, kërkova për një varkë, që të kaloja në anën tjetër të lumit Dixhle. Kishte varka plot, por gjeta një varkë, pronari të cilës mu duk fukara i këputur. Hipa në varkën e tij dhe gjendja e tij më preku. Në mendje më vinte t'i jepja një pjesë të parave, që kisha me vete.

Ai qau, pastaj më tha: Pasha Allahun nuk kam qenë i varfër asnjë ditë prej ditëve. Kam qenë tregtar dhe shkoja për tregti në Indi dhe Sind. Tregtoja mëndafsh dhe lesh. Kam pasur një vëlla, që Allahu mos i dhashtë të mbarën, që kishte rënë dakord me hajdutët për të më vrarë e të më merrnin paratë e mia, por Allahu më shpëtoi, derisa erdha këtu në Bagdad.

Thotë: Për herë të dytë, dynjaja më dërrmoi, sepse qypi me flori është rizku i të zotit të tij, dhe patjetër paratë duhet t'i kthehen të zotit të tyre. Shejtani ndërhyri dhe më tha: Jepja një pjesë ose gjysmën, derisa u ndala dhe thashë: I kërkoj mbrojtje Allahut prej shejtanin të mallkuar, e i thashë: Këto para janë paratë tuaja. Ai nuk po besonte! I tregova se çfarë më kishte ngjarë mes meje dhe mes vëllait të tij dhe se unë e kisha varrosur vetëm pak çaste më përpara. Filloi të qante dhe t'i kërkonte falje Zotit për mendimin e keq ndaj vëllait të tij.

Pastaj, deshi të më jepte diçka prej atyre parave, por refuzova. Por, i kërkova ndjesë për dërhemin, që kisha marrë për të paguar rrushin.

Thotë: U ktheva në Bagdad për së dyti, i varfër i këputur, ashtu siç dola prej tij herën e parë.

Ndërkohë, që po ecja, një ushtar, prej atyre të cilëve punon në zyrat e haraçit, më thirri duke më thënë: Po kërkojmë për ty. Me vete thashë: Do të më burgosin, sepse nuk kisha paguar qiranë e dhomës.

Pastaj më thanë: Dje ka vdekur njëri prej nëpunësve të zyrës (regjistrave) dhe po kërkojmë për ty, që të punosh në vend të tij. Më morën në punë dhe më dhanë një pagë mujore.

Shkova te pronari i dhomës dhe ia dhashë hakun e tij të qirasë, derisa u bëra ministër (vezir).

Ky është dijetari fakih, veziri Ibn Hubejra, i lindur në vitin 449 H dhe i vdekur në vitin 560 H.

Ibn Xhevzi ka thënë për të: Në xhenazen e tij morën pjesë aq shumë njerëz, sa që nuk ka pasur xhenaze të tillë në kohën e tij.

"Kush e ka frikë Allahun, Ai do t'i bëjë rrugëdalje dhe do ta furnizojë nga nuk e pret. Kush i mbështetet Allahut, Ai i mjafton!" – (Kur'ani, Et-Talak: 2-3)

I lavdëruar qoftë Ai, i Cili i ndryshon gjendjet. O Zoti ynë, na e ndrysho gjendjen tonë drejt më së mirës!

Përktheu nga arabishtja dhe
përshtati në shqip:
Lavdrim Hamja

"RAMAZANI ËSHTË MUAJI I NJERIUT, LARGOHUNI NGA KËTO VEPRIME!"

Nëpërmjet një mesazhi të publikuar në kanalin e tij në yt, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i është qasur disa pyetjeve që ka marrë nga ndjekës të ndryshëm në lidhje me marrëdhënien e agjëruesit me rrjetet sociale gjatë ditës së agjërimit.

Në mesazhin e tij, Myftiu Sytari thekson se Muaji i Ramazanit është mundësia më e mirë e besimtarit për t'u marrë me veten e tij, larg rutinës së përditshme, ku në qendër të vëmendjes janë rrjetet sociale me të rejat e tyre.

Myftiu këshillon që gjatë ditës së agjërimit, besimtari duhet të ndahet sa më shumë nga rrjetet sociale dhe çdo gjë që ia vjedh kohën, të cilën duhet t'ia kushtojë vetes së tij, duke analizuar marrëdhënien me Allahun, lidhjen me namazet ditore, përsosjen e dhikrit, përqendrimin në lutje dhe shtimin e heshtjes meditive.

Myftiu Sytari lutet që besimtarët me agjërimin e tyre të gjejnë vetveten, ekuilibrat e adhurimit dhe të përfitojnë sa më shumë nga kjo periudhë, larg agjendave të ngjeshura të shejtanit të mallkuar.

JOMUSLIMANË QË AGJËROJNË, A U KA VLERË?

- Imam Muhamed B. Sytari -

Një plak i urtë në Bernë, të xhumanë e 7 marsit 2025, pas ligjëratës së mbrëmjes dhe namazit të 20 rekateve të teravisë, me xhaminë e tejmbushur, më pyeti për rastin e disa jomuslimanëve, që në realitete të ndryshme, shqiptare dhe jo vetëm, kudo në botë, provojnë të agjërojnë, qoftë edhe një ditë të vetme. A ju vlen atyre ky agjërim.

Video mesazh nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili trajton një temë shumë interesante dhe aktuale: Jomuslimanëve që agjërojnë, a u ka vlerë?

Një plak i urtë në Bernë, të xhumanë e 7 marsit 2025, pas ligjëratës së mbrëmjes dhe namazit të 20 rekateve të teravisë, me xhaminë e tejmbushur, më pyeti për rastin e disa jomuslimanëve, që në realitete të ndryshme, shqiptare dhe jo vetëm, kudo në botë, provojnë të agjërojnë, qoftë edhe një ditë të vetme. A ju vlen atyre ky agjërim.

Unë buzëqesha dhe ju përgjigja, ndërkohë imami i xhamisë, që qëndronte ulur bri meje, u ngrit dhe u largua nga mexhlisi. Në fakt, unë e dija se do të largohej dhe arsyen e largimit...

Nuk kaloi shumë dhe imami u kthye, me sytë që i shndrisnin e fytyrën e qeshur. Unë kërkova që ai të na tregonte arsyen e largimit, që edhe të pranishmit ta mësonin.

Dhe imami nisi të tregonte... Foli e foli, aq sa të gjithë u gëzuam dhe me tekbire e urime e falënderuam, duke e konsideruar lajmin e tij, myzhde të madhe të kësaj Nate të Madhe..!

Një vajzë zvicerane u konvertua sonte në muslimane, pasi kishte provuar të agjëronte ca ditë nga ky muaj...

Dr. Abdulkerim Bekkar
(Mendimtar sirian)

"Nuk është vonuar asnjë fitore dhe nuk ka zgjatur asnjë vështirësi, përveçse në to ka pasur urtësi, që nuk mund t'i kuptojë syri i nxituar.

Jusufi (a.s), sikur të dilte nga burgu një ditë përpara se t'ia kishte caktuar Allahu, nuk do të ishte bërë Azizi i Egjiptit.

Ndoshta pritja jote mund të zgjasë, jo sepse Allahu të ka harruar, por sepse Allahu po të përgatit një të mirë më të madhe, se sa ajo që ti shpreson.

Kështu që, mos e shiko vonesën si ndëshkim, por shikoje atë si përgatitje!"

MUKABELEJA E RAMAZANIT NË XHAMINË E PARRUCËS NJË TRADITË E PËRVITSHME

Ditën e shtunë, më 1 mars 2025, në xhaminë e Parrucës, nisi Mukabeleja, një traditë e hershme e leximit të plotë të Kur'anit Famëlartë gjatë muajit të Madhëruar të Ramazanit.

Ky aktivitet, i organizuar nga Myftinia e Shkodrës, zhvillohet pas namazit të iqindisë, nën drejtimin e disa imamëve dhe ka për qëllim forcimin e lidhjes shpirtërore të besimtarëve me fjalën e Allahut (xh.sh), Kur'anin Famëlartë.

Besimtarë të ndryshëm marrin pjesë në këtë mexhlis të rëndësishëm fetar, duke dëgjuar dhe ndjekur me përkushtim leximin e Kur'anit Famëlartë.

Mukabeleja do të vazhdojë përgjatë gjithë muajit të Ramazanit dhe do të përfundojë me ceremoninë e Hatmes Sherife në Natën e Kadrit, natë e 27 të këtij muaji të Begatë.

MYFTINIA SHKODËR NDIHMON SHOQATËN E PARA-TETRAPLEGJIKËVE ME 80 PAKO USHQIMORE TË RAMAZANIT

Ditën e parë të Ramazanit, të shtunën, më 1 mars 2025, Myftinia Shkodër ndihmoi Shoqatën e Para-Tetraplegjikëve me 80 pako ushqimore të Ramazanit.

Ky kontingjent pakosh është fryt i bashkëpunimit, tashmë të përvitshëm, me Helping Hand for Relief and Development, USA, përmes së cilës këtë vit janë siguruar 300 pako ushqimore për t'u shpërndarë gjatë muajit të Begatë të Ramazanit, njerëzve dhe familjeve në nevojë.

Koordinatori i ndihmave pranë Myftinisë Shkodër, teologu Ervil Kuçi u shpreh se: Myftinia Shkodër, sikurse çdo vit, është në krah të njerëzve në nevojë dhe në veçanti në krah të Shoqatës së Para-Tetraplegjikëve.

Ky është një mision i jonë, që e konsiderojmë si përgjegjësi dhe detyrë për t'i shërbyer njerëzve. Ne kërkojmë, që të lutemi dhe të bëjmë dua për donatorët, të cilët japin nga pasuria e tyre, sepse e kemi amanet këtë punë, të cilën e kryejmë me përkushtim dhe korrektësi.

Gjithashtu, edhe kryetari i Shoqatës së Para-Tetraplegjikëve, z. Saimir Ustabeqiri falënderoi Myftininë Shkodër dhe Myftiun, Imam Muhamed B. Sytari për bashkëpunimin tashmë të vazhdueshëm me shoqatën e tyre dhe interesimin, që tregojnë për anëtarët e kësaj shoqate.

Myftinia Shkodër falënderon shoqatat dhe fondacionet e ndryshme, që kanë kontribuuar dhe vazhdojnë të kontribuojnë me projekte të larmishme bamirëse gjatë muajit të begatë Ramazanit, por jo vetëm.

"KËSHILLA DITORE E RAMAZANIT" CIKËL LIGJËRATASH NË XHAMINË "EBU BEKËR"

Ashtu, siç ishte lajmëruar më herët, ditën e hënë, më 3 mars 2025, pas namazit të drekës në xhaminë "Ebu Bekër", nisi cikli i ri i ligjëratave dhe këshillave ditore të Muajit Ramazan.

Ky organizim i ri i Myftinisë Shkodër, vjen në kuadër të gjallërimit të jetës fetare në Muajin e mëshirës dhe përkushtimit, duke bërë të mundur që sipas grafikut të prezantuar, një numër i konsiderueshëm i imamëve të xhamive të ndryshme të Shkodrës, të kenë mundësinë e ligjërimit, sipas shpërndarjes përkatëse.

Nëpërmjet këtij cikli, Myftinia Shkodër ka për qëllim përhapjen e mesazheve të matura, këshillave të urta dhe udhëzimeve të duhura për besimtarët në Muajin Ramazan, si dhe krijimin e mundësisë për pyetje-përgjigje të shpejta, për të interesuarit.

Myftinia Shkodër ju fton të bëheni pjesë e këtij cikli ligjëratash dhe ta plotësoni bukurinë e ditëve të agjërimit me këto mexhlise të dobishme të dijes dhe përkushtimit.

MIRË SE VJEN NË ISLAM, VLLA MATIA!

Emocionet e dëshmimit të shehadetit nga djali i ri zviceran, Matia, në një natë të paharruar, në mesin e vëllezërve të shtrenjtë dhe hoxhallarëve të dashur në xhaminë shqiptare "Mërgimi", do të ngelen të gdhendura në memorien e krejtve ne, që na e kishte shkruar Allahu të ishim dëshmitarë!

Ai, një djalë i ri, gati në ndrojtje e me shumë emocion, qëndronte para meje, në pritje të shqiptimit të asaj Dëshmie, më të shtrenjtës dëshmi të jetës, për të kaluar me të pragun e shpëtimit!

Ishte një moment, prej atyre që nuk kanë çmim, as nuk peshohen me florinj! Matia e dëshmoi shehadetin dhe u bë pjesë e Familjes së madhe të Ymetit të Hz. Muhammedit (alejhis-selam), duke e marrë Selamin e Zotërisë së bijve të Ademit dhe duke e strukur në zemër, me shumë pathos!

Në fakt, ky Ramazan u bë Muaj i konvertimeve të shumta në mbarë botën; njerëz të shtresave të ndryshme, që me përulje, dëshmuan ato dy fjali të shenjta, me të cilat u bënë pjesë e Islamit!

Elhamdulilah!

Imam Muhamed B. Sytari

Obfelden, Zvicër, më 23 mars 2025

BANORËT ME PREJARDHJE SHQIPTARE NË BURSA ORGANIZOJNË IFTAR MASIV

Banorët me prejardhje shqiptare të lagjeve Zafer dhe Namık Kemal në rrethin Osmangazi të qytetit turk Bursa kanë organizuar një iftar masiv me pjesëmarrjen 2000 personave, i cili tashmë është shndërruar në traditë.

Në organizimin e bërë nga të rinjtë e lagjeve të lartpërmendura, ashtu si vitin e kaluar edhe këtë vit është organizuar një iftar.

Në iftarin e vitit kaluar morën pjesë 1000 persona, ndërsa këtë vit në sofrën e shtuar nga të rinjtë e lagjeve morën pjesë 2000 persona. Të rinjtë, të cilët kursyen paratë, gjithashtu me mbështetjen e bamirësve arritën një marrëveshje me një kompani ushqimore.

Sofra u shtua në Rrugën "Namık Kemal", ndërsa morën pjesë banorët e këtyre lagjeve.

Lagjja Zafer njihet me banorët e saj me prejardhje nga vendet e Ballkanit, kryesisht shqiptarë.

Burimi: Zafer mahallesi/Facebook (TRT Balkan Albanian)

SOFRA E IFTARIT VËLLAZËROR ME NXËNËSIT E MEJTEPEVE TË XHAMIVE:

Shirq-Mushan

Ditën e enjte, më 6 mars 2025, në ditën e 6-të muajit të begatë të Ramazanit, nën kujdesin dhe mbështetjen e sektorit të arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, organizoi iftarin e parë më nxënësit e mejtepit fetar që zhvillohet, pranë xhamisë Shirq-Mushan.

Në këtë iftar ishin rreth 30 nxënësve të moshave të ndryshme të mejtepit dhe imami e mësuesi i kurseve fetare , H. Kujtim Cufaj.

Imami i xhamisë, gjatë bisedës së tij, falënderoi Myftininë Shkodër për mbështetjen si dhe disa sponsor të tjerë të zonës, të cilët mundësojnë organizimin e disa iftareve në këtë xhami, që ndodhet në Njësinë Administrative Dajç.

Në fund u bë duaja e iftarit si dhe më pas të gjithë të pranishmit falën bashkërisht namazin e akshamit, i cili përfundoi me salavate, dhikër, lutje, etj.

Veprimtaria e sofrës së iftareve të vëllazërisë me mejtepet do të vijojë edhe në disa qendra kulturore dhe xhami të tjera të Shkodrës.

Krye-Bushat

Ditën e shtunë, më 8 mars 2025, në ditën e 8-të të muajit të Madhëruar të Ramazanit, sektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër organizoi iftarin më nxënësit e mejtepeve/kurseve fetare që zhvillohen, pranë Qendrës Kulturore Krye-Bushat.

Në këtë iftar, përveç pjesëmarrjes së rreth 30 nxënësve të niveleve të ndryshme të mejtepeve, përgjegjësit të Qendrës dhe mësuesit të mësim-besimit, z. Ridvan Luzaku mori pjesë drejtuesi i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni, i cili përpara çeljes së iftarit, mbajti një bisedë të shkurtër me këshilla të dobishme, ku vuri në dukje se prezenca e fëmijëve dhe e të rinjve në sofrat e iftarit, në faljen e namazeve të teravive, në mexhliset e këndimit të Kur'anit Famëlartë dhe të mësim-besimit, është pa dyshim një tregues i shkëlqyer i një gjallërie, që ata japin në këtë muaj të Begatë të Ramazanit.

Në fund të iftarit, të pranishmit bënë dua-lutjen e sofrës së begatë.

Veprimtaria e sofrës së iftareve të vëllazërisë me mejtepet do të vijojë edhe në disa xhami dhe qendra të tjera kulturore, të Myftinisë Shkodër.

Barbullush

Ditën e martë, më 11 mars 2025, në ditën e 11-të muajit të begatë të Ramazanit, Myftinia Shkodër, përmes sektorit të arsimit organizoi iftarin e radhës, me nxënësit e mejtepit/kurseve fetare të xhamisë dhe Qendrës Kulturore Barbullush.

Në këtë iftar, përveç pjesëmarrjes së mbi 60 nxënësve të moshave të ndryshme të qendrës, imamit H. Ervis Molla dhe përgjegjëses e mësueses së Qendrës, znj. Suada Tahiri mori pjesë edhe drejtuesi i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni, i cili përpara çeljes së iftarit, përmes një bisedë të shkurtër u dha nxënësve disa këshilla e mesazhe të dobishme edukative dhe besimore.

Teologu Halluni theksoi rëndësinë e moralit të mirë, përkushtimit në dije e adhurim, duke i nxitur që ta shfrytëzojnë muajin e Ramazanit për reflektim dhe përmirësim shpirtëror, sikurse i nxiti që të jenë shembull në sjellje dhe të vazhdojnë të zgjerojnë dijet e tyre fetare, duke e parë Islamin si një udhërrëfyes për një jetë të dobishme për vete dhe shoqërinë.

Në fund të iftarit, u bë dua-lutja e sofrës si dhe më pas të gjithë të pranishmit falën bashkërisht namazin e akshamit, i cili përfundoi me salavate, dhikër, lutje, etj.

Programi i sofrës së iftareve të vëllazërisë do të vijojë edhe për disa xhami dhe qendra të tjera të Shkodrës.

SOFRA E IFTARIT VËLLAZËROR ME NXËNËSIT E MEJTEPEVE TË XHAMIVE:

Oblikë

Ditën e xhuma, më 14 mars 2025, në ditën e 14-të muajit të begatë të Ramazanit, sektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër organizoi iftarin e radhës, më nxënësit e mejtepit/kurseve fetare të xhamisë dhe Qendrës Kulturore Oblikë.

Në këtë iftar, përveç pjesëmarrjes së mbi 55 nxënësve (vajza dhe djem), dhe përgjegjëses e mësueses së Qendrës, znj. Kimete Elezi mori pjesë edhe përgjegjësi i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni.

Teologu Halluni, pak para çeljes së iftarit, zhvilloi një bisedë të shkurtër me nxënësit, ku u përcolli këshilla të dobishme mbi edukatën dhe vlerat morale, si dhe mesazhe frymëzuese mbi besimin.

Me fjalët e tij, ai i nxiti ata të qëndrojnë të përkushtuar ndaj dijes, vlerave fetare dhe sjelljeve të mira në jetën e përditshme familjare dhe shoqërore, sidomos gjatë muajit të Begatë të Ramazanit.

Në fund, ai falënderoi mësuesen Elezi dhe grupin vullnetar të saj për përkushtimin e tyre në mbarëvajtjen sa më mirë të aktivitetit arsimor dhe edukativ të qendrës Oblikë.

Pas iftarit vëllazëror, pati biseda të këndshme dhe zbavitje të njohurive të ndryshme në mes të nxënësve.

Programi i sofrës së iftareve të vëllazërisë do të vijojë edhe për disa xhami dhe qendra të tjera të Shkodrës.

Mes-Myselim

Ditën e diel, më 23 mars 2025, në ditën e 23-të muajit të begatë të Ramazanit, sektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, organizoi veprimtarinë e iftarit të radhës, më nxënësit e mejtepit/kurseve fetare të xhamisë dhe Qendrës Kulturore Mes-Myselim, Njësia Administrative Postribë.

Në këtë iftar, përveç pjesëmarrjes së mbi 45 nxënësve të moshave të ndryshme të Qendrës, mësuesit H. Fatmir Sula, mori pjesë edhe drejtuesi i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni, i cili përpara çeljes së iftarit, mbajti një bisedë të shkurtër, ku dha disa këshilla e mesazhe të dobishme edukative dhe besimore.

Ai theksoi rëndësinë e moralit të mirë, përkushtimit në dije e adhurim, duke i nxitur që të jenë shembull i të mirës në familje, në shoqëri dhe kudo.

Në fund të iftarit, u bë dua-lutja e sofrës si dhe më pas të gjithë të pranishmit falën bashkërisht namazin e akshamit, i cili përfundoi me salavate, dhikër, lutje, etj.

Programi i sofrës së iftareve të vëllazërisë me mejtepet dhe qendrat islame është zhvilluar gjatë këtij muaji në Shirq-Mushan, Krye-Bushat, Barbullush, Oblikë, Mes-Myselim, etj.

Kullaj

Ditën e xhuma, më 28 mars 2025, në ditën e 28-të muajit të begatë të Ramazanit, sektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, organizoi veprimtarinë e iftarit të fundit, më nxënësit e mejtepit/kurseve fetare të xhamisë Kullaj, Njësia Administrative Postribë.

Në këtë iftar, përveç pjesëmarrjes së 40 nxënësve të mejtepit të moshave të ndryshme, imamit dhe mësuesit H. Ardin Selhani, mori pjesë edhe drejtuesi i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni, i cili përpara çeljes së iftarit, dha disa këshilla të dobishme edukative dhe besimore për të pranishmit.

Duke i uruar nxënësve për një agjërim të lehtë dhe një Ramazan të pranuar, teologu Halluni shprehu urimet e tij të përzemërta për këtë muaj të shenjtë të mëshirës dhe devotshmërisë.

Me rastin e përfundimit të agjërimit, ai i përgëzoi të gjithë nxënësit për sakrificën dhe përkushtimin e tyre gjatë Ramazanit, duke i përhajruar për festën e madhe të mbarë myslimanëve të globit, Fitër Bajramin. Ai uroi që kjo festë e bekuar të sjellë paqe, harmoni dhe begati në familjet e tyre.

Në fund të iftarit, u bë dua-lutja e sofrës si dhe më pas të gjithë të pranishmit falën bashkërisht namazin e akshamit.

MEXHLISI I BASHKËSISË ISLAME ULQIN SHTROI NJË IFTAR PËR MYSAFIRËT E VET

Ditën e enjte, më 12 mars 2025, Mexhlisi i Bashkësisë Islame Ulqin shtroi iftarin tradicional me të vëllazërisë islame me të ftuar nga trevat e ndryshme.

Në fillim Uvejs Hadzi këndoi pjesë nga Kur'ani.

Fjalën përshëndetëse e bëri Kryetari i Mexhlisit Blerim ef. Bajraktari, duke u pasuar nga Kryetari i Komunës Genci Nimanbegu.

Më pas të pranishmit i përshëndetën përfaqësuesit e Myftinisë së Shkodrës dhe K.B.I. Prizren, Kujtim ef. Bislimi dhe Prof. Kujtim Dervishi të cilët përcollën mesazhet e Myftinive të veta.

Në fund fjalën e mori Reisi Rifat ef. Fejziq.

Kurse lutjen e bukës e bëri Dr. Bahattin ef. Akbash, Atashe i Dijanetit të Turqisë në Podgoricë.

Nga Myftinia Shkodër ishin të pranishëm: Anëtari i Këshillit të Myftinisë, z. Kujtim Dervishi, drejtor i Medresesë "Haxhi Sheh Shamia", z. Sajmir Dritareti, administrator i Myftinisë Shkodër dhe z. Altin Loshi, anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të KMSh.

(Facebook: Mexhlisi i Mexhlisi i Bashkësisë Islame Ulqin)

IFTARI I MADH I FAMILJES NË ZONËN E MJEDËS

Të mërkurën, më 19 mars 2025, në mjediset e jashtme të xhamisë Mjedë u organizua iftari i madh tradicional i familjes.

Qindra besimtarë muslimanë (rreth 500 vetë) bashkë me fëmijët dhe familjet e tyre morën pjesë në këtë iftar të vëllazërisë.

Në këtë iftar ishin të pranishëm edhe kryetari i Bashkisë Vau Dejës, z. Kristian Shkreli dhe autoritete të tjera të zonës.

Pas këndimit të ezanit të akshamit, përfaqësuesi i Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni në fjalën e tij të rastit tha se, muaji Ramazan vjen si reflektim i afrimit familjar, konsolidimit dhe ruajtjes së tabanit të saj shekullor.

Teologu Halluni tha se familja është dhurata më e madhe që i ka dhënë Zoti Fuqiplotë njerëzimit dhe pikërisht për

këtë duhet ta ruajmë atë si bërthamë të çdo shoqërie si dhe të sillemi mirë më njeri-tjetrin.

Më pas, të gjithë të pranishmit nën shoqërimin e ilahive të larmishme shijuan iftarin e madh të familjes, duke vijuar më dua-lutjen e imamit të xhamisë, H. Asllan Babaj dhe faljen e namazit të akshamit.

MYFTINIA SHKODËR VAZHDON SHPËRNDARJEN E NDIHMAVE TË RAMAZANIT

Paraditen e sotme, e enjte, më 20 mars 2025, me rastin e muajit të Begatë të Ramazanit, Myftinia Shkodër ishte e pranishme me shpërndarjen e pakove të Ramazanit te Shoqata "Në ndihmë të personave me aftësi të kufizuar mendore", dega Shkodër.

Pakot e sotme ishin pjesë e kontingjentit të 300 pakove ushqimore për Ramazanin, që Myftinia Shkodër realizon me mbështetjen e "Helping Hand For Relief and Development (HHRD Global)" të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Teologu Arben Halluni përpara mediave u shpreh, se muaji i Ramazanit është muaj i solidariteti, ndihmës,

përkrahjes dhe mbështetjes së shtresave të ndryshme në nevojë. Kjo është thirrja e Islamit, i cili na nxit që të jemi përherë në ndihmë të njëri-tjetrit dhe të bashkëpunojmë për mirën e të gjithëve.

Në emër të shoqatës, përshëndeti kryetarja znj. Vitore Toma, e cila falënderoi Myftininë Shkodër, e cila gjithmonë është e gatshme për të ndihmuar anëtarët e kësaj shoqata.

Me këtë rast, Myftinia Shkodër falënderon Helping Hand for Relief and Development, USA dhe të gjithë donatorët e tjerë, që kontribuojnë me projekte të larmishme bamirëse gjatë Ramazanit, por jo vetëm.

Shpërndarja e ndihmave të Ramazanit do të vazhdojë edhe në ditët e ardhshme, duke kryer me ndihmën e Zotit, me suksese këto projektet bamirëse dhe amanetin e tyre.

MYFTINIA SHKODËR SHPËRNDAN 500 PAKO USHQIMORE PËR JETIMËT DHE FAMILJET NË NEVOJË

Ditën e hënë, më 24 mars 2025, Myftinia Shkodër falë bashkëpunimit me Fondacionin Komiteti i Bashkuar Kuvajtian për Bamirësi bënë shpërndarjen e 500 pakove ushqimore me dhurues Zakat House – Kuwait.

Ky kontingjent ishte planifikuar të shpërndahet për 250 familje me jetimë, 100 pako për familjet e lagjes tek Ura e Bunës, 100 pako për personat para-tetraplegjikë dhe 50 pako për familjet në nevojë në Malësinë e Madhe.

Koordinatori i ndihmave pranë Myftinisë Shkodër, H. Ervil Kuçi u shpreh përpara mediave, se Myftinia Shkodër i ka gjithmonë në vëmendje familjet në nevojë, sidomos familjet me jetimë dhe nuk i harron asnjëherë, ku falë bashkëpunimit me shoqata dhe fondacione bamirëse i ndihmojnë herë pas here.

Myftinia Shkodër falënderon Fondacionin Komuniteti i Bashkuar Kuvajtian për Bamirësi për këtë kontingjent të konsiderueshëm me ndihma, që sollën në Shkodër për t'ia dhuruar familjeve me jetimë dhe atyre në nevojë.

CEREMONIA E HATMES SHERIFE NË NATËN E MADHE TË KADRIT

Ditën e mërkurë, më 26 mars 2025, pas namazit të iqindisë, në xhaminë e Parrucës, u zhvillua ceremonia e Hatmes Sherife.

Nga dita e parë e agjërimit të muajit të Ramazanit e deri në prag të Natës së Madhe të Kadrit, me praninë e disa imamëve dhe të xhematit, u lexua plotësisht Kur'ani Famëlartë.

Fjalën e hapjes e mbajti teologu Arben Halluni, i cili uroi të pranishmit e shumtë me rastin e Natës së Kadrit dhe të mbylljes së Mukabeles,

Më pas, përshëndeti Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, i cili në fjalën e mbajtur me rastin e kësaj ceremonie, theksoi se Kur'ani Famëlartë është një mirësi hyjnore dhe një garanci besimi e adhurimi për ymetin islam. Ai u lut që Zoti, me mëshirën e Tij, ta bëjë Kur'anin pikëreferimi për muslimanët e mbarë botës dhe mëshirë dhe udhëzim për mbarë njerëzimin.

Në vijim të këtij aktiviteti, imamët e nderuar, plotësuan Hatmen Sherife, me leximin e sureve të fundit dhe dua-lutjen nga Myftiu i Shkodrës.

Të pranishmit, pas Hatmes Sherife dhe leximit të Kur'anit Famëlartë, u ndanë duke uruar njëri-tjetrin për pranimin e lutjeve dhe adhurimeve të kryera gjatë këtij muaji të Begatë.

FTESË PËR KONTRIBUT: QENDRA MULTI-FUNKSIONALE DRAGOÇ, POSTRIBË

Myftinia Shkodër ju fton të kontribuoni për ndërtimin e Qendrës Multi-funksionale në fshatin Dragoç, Postribë.

Për të kontribuar mund të kontaktoni:

Myftinia Shkodër: Cel/whatsapp: +355 67 455 3880

Imami i xhamisë Dragoç, H. Shkëlqim Sykaj: Cel/whatsapp: +355 67 218 0276

Kontributin tuaj mund ta bëni edhe përmes bankës:

United Bank of Albania – Branch Shkoder

MYFTINIA SHKODER – FONDE BAMIRESIE

Nr. IBAN LEK: AL11-2035-1102-2010-1521-1100-0546

Nr. IBAN USD: AL50-2035-1102-2010-1401-1100-0543

Nr. IBAN EUR: AL61-2031-0025-1702-0015-0000-0210

_____

www.myftinia-shkoder.org

Fb/Yt: MYFTINIASHKODËR1990



NATA E KADRIT, XHAMITË E SHKODRËS GJALLËROJNË ME PRANINË E RINISË

Ditën e mërkurë, më 26 mars 2025, në namazin e jacisë, xhamitë e Shkodrës ishin të tejmbushura me besimtarë, që vinin për të kryer namazin e teravisë dhe për të bërë lutjet e Natës së Madhe të Kadrit.

Xhamia e Parrucës, e tejmbushur me djem dhe vajza të reja, u bë dëshmitare e një mirësie pafund nëpërmjet të cilës bashkërisht dëshmuam bekimet, butësinë, mirësinë dhe mëshirën e shpërndarë nga Zoti i gjithësisë në këtë Natë të Madhe.

I pranishëm në mesin e besimtarëve ishte edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili në fjalën e tij të mbajtur përpara nisjes së namazit të teravisë iu drejtua besimtarëve me urimet dhe lutjet më të përzemërta për pranimin e krejt muajit të madhërishëm të Ramazanit dhe Natës së Kadrit në veçanti, për të cilën theksoi se kjo Natë është e shpërndarë në dhjetë ditët dhe netët e fundit të muajit të madhërueshëm të Ramazanit, për çka besimtarët janë të ftuar, që të luten dhe të adhurojnë Zotin e tyre me plot përkushtim deri në ditën e fundit të këtij muaji të madhërueshëm të Ramazanit.

Myftiu theksoi se, mirësia dhe bekimet e Ramazanit lulëzojnë pas përfundimit të këtij muaji të madhërueshëm, ku gjithsecili prej nesh e ka në dorë të vazhdojë me këto ritme dhe me këtë frymë adhurimin dhe përkushtimin e tij ndaj Zotit dhe ndaj njëri-tjetrit në përditshmërinë e tij.

Myftiu solli eksperiencat e tij nga disa udhëtime në Perëndim, ku theksoi se falë Zotit xhamitë e shqiptarëve në Evropë janë të tjembushura me djem dhe vajza të reja, që përtej angazhimeve të tyre ditore dhe përtej punës dhe sakrificës me të cilën përballen atje, e kanë xhaminë pikë referimi dhe vend tubimi të përhershëm.

Myftiu tha se, numri i madh i të konvertuarve në Islam, sidomos në xhamitë e shqiptarëve në Perëndim, është dëshmia më e madhe e besimit dhe e lidhjes së pashmangshme të shqiptarëve me fenë shekullore të baballarëve të tyre.

Myftiu theksoi gjithashtu, se gjatë studimeve në Damask hoxhallarët theksonin se, ky shekull, pra shekulli 21 është shekulli i Islamit. Dhe, me të vërtetë, ajo që po dëshmojmë sot, është dyndja e madhe e njerëzve anembanë botës drejt dyerve të Islamit, sidomos pas ngjarjeve të fundit në Gaza, ku shpirti i besimit dhe mbrojtja me përkushtim e shenjtërive të fesë dhe të tokës janë bërë shkak, që njerëzit të kuptojnë, se rendja pas materializmit dhe thirrjeve shterpë që po e çojnë njeriun drejt shkatërrimit, janë një drejtim i gabuar dhe se zgjidhja, qetësia, rehatia e shpirtit dhe zhvillimi i jetës është aty ku Zoti i gjithësisë kërkon nga njeriu që në ditën e parë të krijimit dhe zbritjes së tij në tokë.

Nata e Kadrit është nata e 27 e muajit Ramazan dhe përkujtohet me adhurime dhe lutje të shumta nga mbarë ymeti në çdo cep të globit.

Myftinia Shkodër falënderon imamët dhe besimtarët për përkushtimin dhe gjallërimin e tyre të xhamive dhe lutet, që Allahu i Madhëruar ta pranojë adhurimin dhe përkushtimin e këtij muaji të begatë nga të gjithë besimtarët.

PROGRAME TELEVIZIVE DHE RADIOFONIKE PËR MUAJIN E BEGATË TË RAMAZANIT 2025

Myftinia Shkodër, në kuadër të plan-programit të saj për muajin e Begatë të Ramazanit, ka organizuar një seri emisionesh televizive dhe radiofonike me temë "Hadithet e Ramazanit".

Në këto emisione, të moderuara nga teologu Arben Halluni, kanë marrë pjesë për biseda e bashkëbisedime imamë dhe teologë të ndryshëm, duke ofruar një platformë për diskutime të detajuara mbi mësimet dhe traditat islame gjatë këtij muaji të bekuar.

Gjatë edicioneve të ndryshme që janë transmetuar në Tv1 Channel, në Tv Rozafa dhe portalet e Myftinisë Shkodër, u trajtuan tema të rëndësishme që lidhen me hadithet e Ramazanit, duke ofruar udhëzime dhe këshilla për besimtarët në këtë periudhë të rëndësishme shpirtërore. Po ashtu në këto emisione janë transmetuar edhe Hytbet e Xhumasë nga xhamitë e ndryshme të qytetit.

Përveç kësaj, Myftinia Shkodër ka bashkëpunuar me Radio Jehona për të transmetuar emisionin "Jehonë Ramazani". Ky program i përditshëm ka synuar të sjellë tek dëgjuesit mesazhe frymëzuese dhe edukative, Fjalët e Allahut dhe të Pejgamberit (a.s), duke thelluar kuptimin e vlerave dhe praktikave të Ramazanit.

TRIBUNË E VEÇANTË MBI RAMAZANIN DHE PËRKUSHTIMIN FETAR NË LOZANË



Më datë 8 mars 2025, në ambientet e Qendrës Shqiptare për Integrim, Kulturë dhe Religjion në Lozanë, u mbajt një tribunë e veçantë me temë "Muaji i Ramazanit dhe përgjigjja ndaj urdhrave të Allahut". Ky aktivitet u organizua me iniciativën dhe ftesën e kryesisë së qendrës dhe pati si musafir special Muhamed ef. Sytari, Myfti i Shkodrës.

Tubimi u hap me fjalën përshëndetëse të hoxhës Fehim ef. Abazi, i cili në emër të kryesisë falënderoi myftiun për pranimin e ftesës dhe për prezencën e tij në mesin e besimtarëve shqiptarë në Lozanë.

Në ligjëratën e tij, Myftiu i nderuar, Muhamed ef. Sytari, shpjegoi në mënyrë të hollësishme rëndësinë e muajit të shenjtë të Ramazanit, duke e lidhur atë me shembuj të frymëzuar nga jeta e Pejgamberit a.s. dhe e ashabëve të tij. Ai theksoi se agjërimi nuk është vetëm një akt fizik, por një adhurim që kërkon përkushtim shpirtëror dhe një përpjekje të vazhdueshme për t'iu përgjigjur urdhrave të Allahut me devotshmëri dhe sinqeritet.

Ky tubim u karakterizua nga një pjesëmarrje e jashtëzakonshme. Xhamia dhe restoranti i saj ishin të mbushura përplot, duke dëshmuar interesin dhe përkushtimin e madh të besimtarëve.

Para fillimit të tribunës, për të gjithë të pranishmit u shtrua një iftar i begatë, ku besimtarët patën mundësinë të ndajnë këtë moment të veçantë së bashku. Organizimi i iftarit u bë me zemërgjerësi nga bamirësit h. Xhevat Memeti, h. Xhevat Sejdiu, h. Hevzi Rrahimi, Rrahman Rama dhe Arben Idrizi, për të cilët lutemi që Allahu t'i shpërblejë me të mirat e Tij.

Ky aktivitet jo vetëm që pasuroi njohuritë fetare të pjesëmarrësve, por gjithashtu forcoi frymën e bashkësisë dhe vlerat e solidaritetit ndërmjet besimtarëve shqiptarë në Lozanë.

(Istagram: qendraislameshqiptarelozane)

Dr. Selman El-Aude

"Shpresoj të jem prej njerëzve të këtij ajeti:

"Dhe, të tjerë, që i kanë pohuar gjynahet e tyre, kanë përzier punë të mira dhe të tjera të këqija; ndoshta Allahu ua pranon pendimin e tyre. Me të vërtetë, Allahu është Falës, Mëshirues!" (Kur'ani, Et-Teube: 102)

Zoti ynë, ne i pohojmë gjynahet tona, na fal dhe na mbulo!

FALJA E FITËR BAJRAMIT DHE NEVOJA PËR ZGJERIMIN E XHAMIVE TË MËDHA

Që në orët e para të mëngjesit, të ditës së sotme, e diel, më 30 mars 2025, besimtarë të shumtë iu drejtuan xhamive të Shkodrës për të kryer faljen e Fitër Bajramit.

Atmosfera festive dhe shpirtërore e cila shoqëroi ceremoninë e Fitër Bajramit ishte një dëshmi e tabanit dhe e traditë islame shkodrane. Xhamitë të mbushura plot me besimtarë, të cilët kishin ardhur për marrë pjesë në këtë ditë gëzimi dhe shpërblimi për secilin prej tyre, pas një muaji agjërim dhe adhurimet të shumta, që i kishin kryer gjatë muajit të Begatë të Ramazanit.

Ceremonia qendrore u zhvillua në xhaminë e Parrucës, ku qindra besimtarë, të mbushur me gëzim dhe paqe, falën namazin e Fitër Bajramit. Ligjëratën kryesore e mbajti Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili theksoi rëndësinë e të qënurit besimtarë të vërtetë, adhurues të sinqertë, falënderuar ndaj mirësive, solidarizues me nevojtarët, falës dhe përhapës të vlerave universale islame, të paqes, harmonisë, tolerancës, etj, në shoqëri.

Po ashtu, në këtë ceremoni ligjëroi edhe H. Durim Kasemi, i cili foli mbi vlerën shpirtërore të sakrificës dhe përkushtimit ndaj besimit. Gjithashtu, H. Durim Kasemi mbajti edhe hytben e Bajramit.

Një tjetër ceremoni e rëndësishme u zhvillua në xhaminë "Ebu Bekër", ku teologu Arben Halluni dhe H. Idmir Plaku mbajtën fjalime frymëzuese mbi rëndësinë e besimit dhe jetës së pastër shpirtërore. Ata i bënë thirrje besimtarëve të kultivojnë ndjenjat e mirësisë dhe të vazhdojnë rrugën e devotshmërisë edhe pas përfundimit të muajit të shenjtë të Ramazanit.

Në këtë ditë të madhe feste, u fol edhe për banorët e Gazës, të cilët po përjetojnë dhunën, terrorin dhe krimet më monstruoze të parë ndonjëherë nga njerëzimi, ku me gjithë solidaritetin e masave në mbarë botën në përkrahje të popullsisë së Gazës, qeveritë e shumë vendeve perëndimore, jo vetëm që nuk po e ndalin dhunë, vrasjen dhe krimet njerëzore, por po i ndihmojnë pushtuesit të vazhdojë në krimin dhe vrasjet e tij, të grave, fëmijëve, pleqve dhe këdo që ndodhet në atë tokë të shenjtë.

Imamët dhe hoxhallarët u lutën për paqe, harmoni dhe dashuri, e që Zoti t'i bekojë të gjithë me mirësitë dhe begatitë e Tij dhe tua pranojë secilit agjërimin dhe adhurimet.

Pas faljes, besimtarët shkëmbyen urime me njëri-tjetrin, duke ndarë gëzimin e kësaj dite të bekuar.

Fitër Bajrami, si një ditë e faljes dhe harmonisë, solli një mesazh të fuqishëm uniteti dhe vëllazërie, duke forcuar edhe më shumë lidhjet e besimtarëve me njëri tjetrin.

AUTORITETET FETARE, LOKALE DHE QYTETARËT E SHKODRËS UROJNË FITËR BAJRAMIN

Me rastin e festës së Fitër Bajramit, Myftinia Shkodër, më 30 mars 2025, në xhaminë e Parrucës, përmes përfaqësuesit të saj, teologut Arben Halluni, imamëve dhe stafit kanë pritur vizita të shumta nga drejtues të institucioneve fetare dhe lokale Shkodër, të Bashkisë, Prefekturës, përfaqësues të partive politike, deputetë, personalitete të ndryshme dhe besimtarë, të cilët kanë ardhur për të uruar këtë festë të rëndësishme për besimtarët myslimanë.

Gjatë pritjes, përfaqësuesit e Myftinisë Shkodër kanë shprehur mirënjohjen për vizitat dhe urimet e ngrohta, duke theksuar rëndësinë e vlerave të bashkëjetesës, solidaritetit dhe unitetit mes njerëzve, pavarësisht përkatësive të tyre.

Festa e Bajramit është një moment reflektimi dhe afrimi, një mundësi për të forcuar lidhjet e respektit dhe bashkëpunimit midis komuniteteve dhe institucioneve.

Myftinia Shkodër ju uron:

Agjërim të lehtë dhe të pranuar!
Ramazan mubarek!

Kalendari i Ramazanit 1446/2025

Duaja: "**O Zoti im, Ti je Falës, e do faljen, më fal mua!**" | **Nata e Kadrit**, e mërkurë, 26 mars 2025
Falja e sabahut në xhami bëhet 20 minuta pas Imsakut (Syfyrit) | *Oraret janë referuar zonës së Shkodrës*

1 Ramazan	SYFYRI 4:41	IFTARI 17:39	1 Mars	11 Ramazan	SYFYRI 4:25	IFTARI 17:51	11 Mars	21 Ramazan	SYFYRI 4:07	IFTARI 18:02	21 Mars
2 Ramazan	SYFYRI 4:40	IFTARI 17:40	2 Mars	12 Ramazan	SYFYRI 4:23	IFTARI 17:52	12 Mars	22 Ramazan	SYFYRI 4:05	IFTARI 18:03	22 Mars
3 Ramazan	SYFYRI 4:38	IFTARI 17:41	3 Mars	13 Ramazan	SYFYRI 4:22	IFTARI 17:53	13 Mars	23 Ramazan	SYFYRI 4:04	IFTARI 18:04	23 Mars
4 Ramazan	SYFYRI 4:36	IFTARI 17:43	4 Mars	14 Ramazan	SYFYRI 4:20	IFTARI 17:54	14 Mars	24 Ramazan	SYFYRI 4:02	IFTARI 18:05	24 Mars
5 Ramazan	SYFYRI 4:35	IFTARI 17:44	5 Mars	15 Ramazan	SYFYRI 4:18	IFTARI 17:55	15 Mars	25 Ramazan	SYFYRI 4:00	IFTARI 18:06	25 Mars
6 Ramazan	SYFYRI 4:33	IFTARI 17:45	6 Mars	16 Ramazan	SYFYRI 4:16	IFTARI 17:56	16 Mars	26 Ramazan	SYFYRI 3:58	IFTARI 18:07	26 Mars
7 Ramazan	SYFYRI 4:32	IFTARI 17:46	7 Mars	17 Ramazan	SYFYRI 4:14	IFTARI 17:57	17 Mars	27 Ramazan	SYFYRI 3:56	IFTARI 18:08	27 Mars
8 Ramazan	SYFYRI 4:30	IFTARI 17:47	8 Mars	18 Ramazan	SYFYRI 4:13	IFTARI 17:58	18 Mars	28 Ramazan	SYFYRI 3:54	IFTARI 18:09	28 Mars
9 Ramazan	SYFYRI 4:28	IFTARI 17:48	9 Mars	19 Ramazan	SYFYRI 4:11	IFTARI 18:00	19 Mars	29 Ramazan	SYFYRI 3:52	IFTARI 18:10	29 Mars
10 Ramazan	SYFYRI 4:27	IFTARI 17:49	10 Mars	20 Ramazan	SYFYRI 4:09	IFTARI 18:01	20 Mars	1 Sheval	FITËR BAJRAMI	BAJRAMI FALET N Ë ORËN: 07:10	30 Mars

www.myftinia-shkoder.org
FB|YT: MYFTINIASHKODER1990

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek